

BULETINI 2025



KOMUNA E LIPJANIT



SHKURT

Nderohet me homazhe dëshmori Xhevdet Breznica



Me rastin e përvjetorit të rënies së dëshmorit Xhevdet Breznica, Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe në fshatin Dobrajë e Madhe.

Me këtë rast, Kryetari Ahmeti theksoi se kujtimi për dëshmorët duhet të mbetet i përhershëm, pasi që ata janë themeli mbi të cilin është ndërtuar e ardhmja jonë. Sakrificat e tyre na obligon të punojmë me përkushtim çdo ditë për një Kosovë më të mirë.

Lavdi!



Filluan aktivitetet për shënimin e 17-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 17-vjetorit të Pavarësisë, në oborrin e Komunës së Lipjanit janë vendosur shkronjat me mbishkrimin "Kosova 17", si simbol i identitetit dhe përkushtimit ndaj shtetësisë së vendit tonë.

Gjithashtu gjatë ditës së sotme, në Bibliotekën e Qytetit është shfaqur dokumentari i autorit Arian Mavriqi, i cili pasqyron pasurinë dhe diversitetin e faunës në territorin e Komunës së Lipjanit, duke sjellë një perspektivë të veçantë mbi natyrën dhe ekosistemin lokal.

Aktivitetet kanë vazhduar me një ekspozitë artistike, të organizuar nga nxënësit e tri shkollave të Lipjanit. Përmes pikturave të tyre, ata kanë sjellë një pasqyrim të periudhave të ndryshme historike, kulturore dhe shoqërore, duke shfaqur talentin dhe kreativitetin e tyre artistik.

Urime 17-vjetori i Pavarësisë së Kosovës!



Vazhdojnë aktivitetet për 17-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 17-vjetorit të Pavarësisë, në Bibliotekën e Qytetit u realizua shfaqja e baletit nga autori Sead Vuniqi. Kjo shfaqje mbledhi qytetarë dhe artdashës, të cilët ndoqën nga afër performancën e balerinave të talentuara, të cilat me interpretimin e tyre dhuruan një spektakël të jashtëzakonshëm për të gjithë të pranishmit.

Ndërsa aktivitetet festive vazhduan në shkollën fillore "Ismail Luma", ku u realizua një program kulturo-artistik i pasur me këngë, recitime dhe valle tradicionale. Nxënësit shfaqën talentin dhe përkushtimin e tyre për këtë festë të rëndësishme kombëtare.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, uron qytetarët e Komunës së Lipjanit me rastin e 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Kosovës, duke theksuar se kjo ditë është një përkujtim i sakrificës së gjeneratave që luftuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.



Të dashur qytetarë,

Urime 17 Shkurti – Dita e Pavarësisë!

17 Shkurti nuk është vetëm një datë historike, por një përkujtim i sakrificës së gjeneratave të tëra që ëndërruan, luftuan dhe dhanë gjithçka për lirinë dhe pavarësinë tonë.

Është detyra jonë ta mbrojmë, ta forcojmë dhe ta zhvillojmë Kosovën çdo ditë.

Asnjë sfidë nuk është më e madhe sa vullneti ynë për ta bërë Kosovën një vend ku çdo qytetar jeton me dinjitet dhe shpresë për të ardhmen.

Qoftë e përjetshme liria dhe shteti ynë!

Me respekt,

I.A

Kryetari Ahmeti bën homazhe në nder të Ditës së Pavarësisë së Kosovës



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët, sot me rastin e 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule pranë lapidarit të Komandantit Legjendar, Adem Jashari. Me këtë rast kryetari Ahmeti theksoi se 17 Shkurti nuk është thjesht një datë historike, por një përkujtim i sakrificës së gjeneratave të tëra që ëndërruan, luftuan dhe dhanë gjithçka për lirinë dhe pavarësinë e vendit tonë.



Koncert Festiv për 17-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ky koncert solli një atmosferë të jashtëzakonshme për të gjithë qytetarët e pranishëm.

Në skenë performuan emra të njohur të muzikës si Flamur & Ilir, DJ Ami, Dona Spahiu, Bardha Drnogllava, Emir Drnogllava dhe Xhavit Sadiku, të cilët me performancën e tyre krijuan një atmosferë të veçantë dhe një energji të jashtëzakonshme, duke e shndërruar këtë ditë në një festë të paharrueshme për qytetarët e Lipjanit.

Gëzuar Ditën e Pavarësisë së Kosovës!



Turneu "Kupa e Pavarësisë" për 17-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, u organizua turneu sportiv "Kupa e Pavarësisë". Ky aktivitet mbledhi sportdashës dhe sportistë, të cilët krijuan një atmosferë fantastike dhe emocionuese për të gjithë të pranishmit.

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, u organizua turneu sportiv "Kupa e Pavarësisë". Ky aktivitet mbledhi sportdashës dhe sportistë, të cilët krijuan një atmosferë fantastike dhe emocionuese për të gjithë të pranishmit.

Turneu përfshiu garat në futboll për grupmoshat U-9 dhe U-13, si dhe ndeshjet në volejboll për femra dhe meshkuj, duke dëshmuar se pasioni për sportin është i pranishëm në të gjitha grupmoshat. Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe organizatorët për përkushtimin e tyre në këtë aktivitet, i cili kontribuon në forcimin dhe zhvillimin e sportit në përgjithësi, e veçanërisht në këtë ditë të rëndësishme për vendin tonë – Ditën e Pavarësisë së Kosovës. Në garat e futbollit morën pjesë gjithsej 16 ekipe nga shkollat e futbollit të Lipjanit për grupmoshat U-9 dhe U-13. Në kategorinë U-9, në finale arritën Sh.F. Legjendat dhe Sh.F. Atletika B, ku triumfoi Sh.F. Atletika B. Ndërsa në grupmoshën U-13, ndeshja finale u zhvillua mes Sh.F. Ulpiana dhe Sh.F. Lipjani 01, ku fitues doli Sh.F. Ulpiana, duke ngritur trofeun e "Kupës së Pavarësisë".

Ndërsa në garat e volejbollit, në kategorinë e meshkujve, finalja u zhvillua mes ekipeve KV Kokrra-Kokrra dhe KV Libero, ku fitues u shpall ekipi KV Kokrra-Kokrra. Ndërsa në kategorinë e femrave, në finale arritën KV Skënderbeu dhe KV Lipjani, ku triumfoi KV Skënderbeu, duke siguruar trofeun e "Kupës së Pavarësisë".

Komuna e Lipjanit nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e bujqësisë



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me drejtorin e Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë, z. Zenel Bunjaku, e cila synon fuqizimin e grave, të rinjve dhe fermerëve në zonat rurale përmes projekteve bujqësore dhe përpunimit të produkteve ushqimore.

Ky bashkëpunim ka për qëllim mbështetjen e fermerëve lokalë përmes granteve, trajnimeve profesionale dhe aktiviteteve të tjera, të cilat ndihmojnë në krijimin e një burimi të qëndrueshëm të jetesës. Komuna e Lipjanit do të kontribuojë në bashkëfinancimin e projektit, si dhe në organizimin e panairëve dhe aktiviteteve promovuese për përfituesit.

Projekti përfaqëson një hap të rëndësishëm për zhvillimin e sektorit bujqësor në Lipjan dhe për mbështetjen e fermerëve në krijimin e mundësive të reja ekonomike. Ky projekt financohet nga organizata ndërkombëtare FRIEDA dhe zbatohet nga IADK.

Dyfishohet Numri i Bursave për Studentët – 323 Studentë Përfitojnë Bursa



KOMUNA E LIPJANIT



DYFISHOHET NUMRI I BURSIVE PËR STUDENTËT – 323 STUDENTË PËRFITOJNË BURSA

**323 studentë kanë përfituar bursë
në vlerë prej 500 euro, për vitin
akademik 2024/2025**

Është publikuar lista e studentëve përfitues të bursave për vitin akademik 2024/2025, duke shënuar një rritje të numrit të studentëve përfitues të mbështetjes financiare. Këtë vit, 323 studentë kanë përfituar bursë prej 500 eurosh, një rritje prej 153 studentësh krahasuar me 170 studentët që morën të njëjtën shumë gjatë vitit akademik 2023/2024.

Kjo rritje e numrit të bursave është rezultat i zotimit të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, për rritjen e numrit të bursave për studentët dhe inkurajimin e të rinjve në rrugëtimin e tyre akademik.

Lista e plotë e përfituesve është publikuar në faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në një takim të veçantë nxënësit e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “Emin Duraku” – Banullë, të cilët kanë treguar rezultate të shkëlqyera në gara të ndryshme arsimore.

Gjatë takimit, kryetari Ahmeti përgëzoi nxënësit për përkushtimin, punën e palodhshme dhe sukseset e tyre, duke theksuar se talenti dhe angazhimi i të rinjve janë një vlerë e çmuar për të ardhmen e komunës dhe shoqërisë.

Në përfundim të takimit, kryetari Ahmeti u ndau mirënjohje nxënësve të dalluar, duke vlerësuar punën e tyre të jashtëzakonshme dhe duke i inkurajuar ata të vazhdojnë rrugën e suksesit me pasion dhe përkushtim.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, inspekton punimet e projekteve infrastrukturore në Dobraj të Madhe

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët, ka vizituar Dobrajën e Madhe për të inspektuar nga afër ecurinë e dy projekteve të rëndësishme infrastrukturore: asfaltimin e rrugës pranë shkollës dhe vendosjen e barit sintetik në stadiumin e ri.

Gjatë vizitës, kryetari Ahmeti theksoi rëndësinë e investimeve në infrastrukturë, duke potencuar se këto projekte do të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e banorëve të Dobrajës së Madhe.

“Asfaltimi i rrugës pranë shkollës në Dobraj të Madhe do të lehtësojë lëvizjen e nxënësve dhe banorëve, duke ofruar një infrastrukturë më të sigurt dhe të qëndrueshme. Ndërsa stadiumi me bari sintetik do të krijojë kushte moderne për zhvillimin e aktiviteteve sportive, duke inkurajuar të rinjtë të angazhohen më shumë në sport”, tha kryetari Ahmeti.

Ai gjithashtu siguroi banorët se Komuna e Lipjanit do të vazhdojë të investojë në përmirësimin e infrastrukturës publike dhe do të mbështesë projekte që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve.





Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, ka marrë pjesë në organizimin e shënimit të 36-vjetorit të grevës së minatorëve të Minierës së Industrisë dhe Magnezitit në Golesh.

Me këtë rast, nënkryetari Bytyqi theksoi rëndësinë e kësaj greve, duke e cilësuar atë si një moment kyç në historinë e Kosovës. "Në këtë përvjetor kujtojmë kontributin e jashtëzakonshëm të minatorëve, të cilët për shkak të represionit të regjimit të atëhershëm, jo vetëm që u larguan nga puna, por shumë prej tyre edhe u burgosën. Greva e tyre ishte një akt i guximshëm që shënoi një moment të rëndësishëm në historinë e rezistencës për liri dhe të drejta", tha nënkryetari Bytyqi.

Gjatë takimit me ish-minatorët, nënkryetari z. Diamant Bytyqi dhe drejtori i Shëndetësisë, z. Shkëlzen Hajdini, dëgjuan nga afër rrëfimet e tyre, duke vlerësuar sakrificën dhe kontributin që ata kanë dhënë në historinë e shtetit të Kosovës.

Përkujtime të tilla shërbejnë jo vetëm për të nderuar të kaluarën, por edhe për të reflektuar mbi përgjegjësinë institucionale ndaj atyre që kanë kontribuar në ndërtimin e shtetit të Kosovës.

KPF mban mbledhjen e 34-me radhë



Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit z. Daut Azemi, ka mbajtur mbledhjen e 34-të me radhë, ku janë diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës të prapropozuara për këtë mbledhje. Me këtë rast, Kryesuesi i Kuvendit, z. Daut Azemi, përveç pikave të propozuara për këtë mbledhje, ka prezantuar edhe një pikë shtesë për diskutim në këtë mbledhje. Anëtarët e KPF-së pas diskutimeve kanë rekomanduar të gjitha pikat për shqyrtim dhe aprovim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të premten, më 28 shkurt 2025.

Komiteti për Komunitete ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 34-të me radhë



Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, u mbajt mbledhja e 34-të e Komitetit për Komunitete (KK), e udhëhequr nga kryesuesi, z. Skender Bikliqi, ku u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës. Gjatë këtij takimi, Drejtori për Bujqësi, z. Rexhep Rexhepi, informoi anëtarët e KK-së lidhur me subvencionimin e fermerëve, ndërsa përfaqësuesit e Zyrës Lokale për Komunitete informuan të pranishmit lidhur me raportin e ZKKK-së. Në përfundim të mbledhjes, anëtarët e Komitetit shqyrtuan disa çështje të ndryshme që prekin jetën e qytetarëve të Komunës së Lipjanit.



U mbajt mbledhja e 39-të me radhë e Kuvendit të Komunës së Lipjanit

Kuvendi i Komunës së Lipjanit, udhëhequr nga Kryesuesi, z. Daut Azemi, zhvilloi punimet e mbledhjes së 39-të me radhë, ku u shqyrtuan dhe u miratuan të gjitha pikat e rendit të ditës dhe një pikë shtesë, të propozuara për këtë seancë.

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, gjatë kësaj seance ka dhënë sqarime për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Gjatë punimeve të kësaj seance, u miratuan këto pika të rendit të ditës:

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 38-të e Kuvendit.

Propozim Vendim për lirim nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social.

Propozim Vendim për dhënie në shfrytëzim të tokës - pasuri shoqërore për vendosjen e trafostacionit të ri të tipit shtyllë betoni në Sllavi.

Propozim Vendim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme - lokaleve afariste të Komunës në Zonat Kadastrale Lipjan dhe Magurë.

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës - lokaleve afariste në Zonat Kadastrale Lipjan dhe Magurë.

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për iniciativën për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës - IADK.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, uron qytetarët me rastin e fillimit të muajit të shenjtë të Ramazanit



Të nderuar qytetarë të Komunës së Lipjanit,
Me rastin e fillimit të muajit të shenjtë të Ramazanit, më lejoni t'ju shpreh
urimet më të singerta për këtë periudhë të veçantë të reflektimit, sakrificës dhe
përkushtimit shpirtëror. Ramazani është muaj i mëshirës, respektit dhe
solidaritetit, një mundësi për të forcuar vlerat tona njerëzore dhe shoqërore.
Uroj që ky muaj i bekuar t'ju sjellë paqe, begati dhe mirësi në zemrat dhe
familjet tuaja, duke forcuar edhe më shumë lidhjet tona të përbashkëta. Zoti ua
pranoftë agjërimin, lutjet dhe veprat e mira!
Agjërim të lehtë dhe të pranuar!
Me respekt,
Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës së Lipjanit



Komuna e Lipjanit – Zyra për informim



<https://lipjan.rks-gov.net/>



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



0 800 14 000 / 038 200 41 508